



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë 08.04.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 05.04.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik, "Tala Engineering" shpk nga Prishtina, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndertimi i qerdhes ne Shalë" me Nr. të Prok: 613-22-546-5-2-1

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Tala Engineering" shpk nga Prishtina, të dt. 05.04.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndertimi i qerdhes ne Shalë", me nr. të Prok: 613-22-546-5-2-1

Vërtetohet Vendimi i AK për shpërblim me kontratë për Operatorin Ekonomik NNP "CTA" shpk nga Prishtina. **Mbetet në fuqi** Vendimi i AK për shpërblim me kontratë i publikuar me datë: 04.04.2022

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Tala Engineering" shpk nga Prishtina, me datë 05.04.2022 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndertimi i qerdhes ne Shalë" me nr. të Prok: 613-22-546-5-2-1 ku këtë aktivitet AK ka shpallur fitues Operatorin Ekonomik NNP "CTA" shpk nga Prishtina, **për shpërblim me kontratë** të datës 04.04.2022 dhe ka publikuar në platformën elektronike e-prokurimi.

Operatori Ekonomik "Tala Engineering" shpk nga Prishtina, me datë. 05.04.2022 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndertimi i qerdhes ne Shalë" Autoriteti Kontraktues, me datë 08.04.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Sa i përket pretendimit tuaj të parë i cili ka të bëjë me listen e paisjeve, operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës e ka një marrëveshje për paisje dhe një listë për këto paisje me NNT "Burimi" e cila është nënshkruar dhe e vëltur nga ky operator. Ndërsa sa i përket asaj që operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk është në konzorcium me këtë operator me të cilin e ka këtë marrëveshje, sipas kërkesave të AK-së kjo marrëveshje mund të bëhet me cilindo operatorë i cili nuk është palë e interesit në këtë procedurë. Ky pretendim i juaj është i pabazuar.

Pretendimi juaj i dytë ka të bëjë me vibrator. Sipas kërkesave të AK-së është kërkuar një vibrator, ndërsa nuk është cekur lloji i vibratorit se a duhet të jetë vibrator për rrugë apo vibrator për beton. Operatori i rekomanduar për kontratë në listen e paisjeve e ka edhe vibratorin për beton për të cilin nuk ka dëshmi por nëse kthehet lenda në rivlerësin AK është i obliguar të kërkojë sqarime shtesë për këtë paisje. Ky pretendim i juaj është i pabazuar.

Pretendimi juaj i tretë ka të bëjë me një punëtor të certifikuar për efikasitet të energjisë. Autoriteti Kontraktues konsideron se certifikata për këtë punëtor e dëshmuar nga operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës i plotëson kërkesat tona sipas dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Punëtori i juaj i certifikuar për efikasitet të energjisë ka marrë pjesë në trajnim 2 ditë online. Operatori i rekomanduar për kontratë ka paraqitur certifikatën e punëtorit për efikasitet të energjisë që ka ndjekur trajnimet në Universitetin e Prishtinës për 2 muaj. Ky pretendim i juaj është i pabazuar.

Pretendimi juaj i katërt ka të bëjë me çmime jo reale të tregut në ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës. Sa i përket këtyre çmimeve operatori i rekomanduar për dhënie të kontratës në totalin e ofertës e ka çmimin më të ulët dhe nëse Autoritet Kontraktues ju kemi përmbajtur kriterit të dhënies si tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Ky pretendim i juaj është i pabazuar.

Pretendimi juaj i pestë ka të bëjë me datën e kontratave të punëtorëve në nenin 14 të operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës. Nëse Autoritet Kontraktues konsiderojmë se kjo datë e kontratave në këtë nen është gabim teknik për arsye se data e nënshkrimit të këtyre kontratave është e vitit 2022. Ky pretendim i juaj është i pabazuar.

AK, konsideron se tenderi juaj është vlerësuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP.

Drejtori i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.

Bekim Shabani



Drejtor i Prokurimit